

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7143  
E shtunë, 16 mars 2024  
Çmimi 0.50

Vdekja e Astrit Deharit dhe sulmi në Banjaskë, KMDLNj-ja thotë se nuk pret që asnjëri rast të sqarohet për shkak të politikës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ESCOBARI: KURTI REFUZOI PROPOZIMET PËR DINARIN, PO KEMI VËSHTIRËSI ME KËTË QEVERI



Zëvendësi i ndihmësit të sekretarit amerikan të Shtetit, Gabriel Escobar, tha se nuk ka arritur ta bindë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta pezullojë vendimin për ndalimin e monedhës serbe në

Kosovë, derisa Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Qeveria e Kosovës të gjejnë një zgjidhje afatgjatë, siç do të ishte transferimi elektronik i eurove përmes sistemit të Kosovës. "Kryeministri tha se ky

ishte vendim i një institucioni të pavarur", tha Escobari në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë" të premtën, në përfundim të vizitës së tij në Kosovë, të cilën e nisi më 13 mars

**BE-ja KONFIRMON SE NË RAUNDIN E RI TË DIALOGUT DO TË BISEDHET PËR DINARIN**



**KQZ-JA IU BASHKOHET INSTITUCIONEVE ZGJEDHORE TË BOTËS PËR T'I KUNDËRSHTUAR ZGJEDHJET PRESIDENCIALE TË RUSISË NË RAJONET E PUSHTUARA TË UKRAINËS**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)


**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



**PRESIDENTI BIDEN PRANË IZRAELIT, POR LARG NETANJAHUT**

**KONJUFCA: GRATË KANË DHËNË KONTRIBUT E SHEMBULL TË JASHTËZAKONSHËM**

**LDK-ja AKUZON LV-në SE PO MANIPULON ME TË DHËNAT PËR TENDERËT NJËBURIMORË**

### EKONOMI



**INDEP: KONSUMATORËT PO PËRBALLEN ME SFIDA NGA APLIKIMI I PADREJTË I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NGA KOMPANITË**

**ISHTE NË SHFRYTËZIM NGA AAK-ja, MINISTERIA E BUJQËSISË RIKTHEN OBJEKTIN ME MBI 600 METRA NË PRISHTINË**

### SPORT



**FODA PUBLIKON LISTËN, RISI RIKTHIMI I ZHEGROVËS DHE PESË LOJTARË NGA SUPERLIGA**

## Presidenti Biden pranë Izraelit, por larg Netanjahut

**WASHINGTON, 15 MARS** - Operacioni ushtarak i Izraelit në Gazë dhe pasojat e ofensivës mbi civilët palestinezë kanë qenë në qendër të deklaratave të faktorit ndërkombëtar, që ka reaguar ashpër. "Itinerari i zakonshëm për të dërguar ndihma nga toka është mbyllur në mënyrë artificiale. Uria po përdoret si armë në luftë", u shpreh Josep Borrell, shefi i politikës së jashtme i Bashkimit Evropian.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka mbajtur qëndrim sfidues. "Asnjë lloj trysnie nuk do të mund të na ndalojë. Në rrezik është e ardhmja dhe mbijetesa e Izraelit", ka deklaruar ai.

Por në një kohë kur po rritet numri i viktimave dhe njerëzve që po vuajnë nga uria në Gazë, mbështetësit besnikë të Izraelit, presidentit Joe Biden, duket se po i soses durimi.

Në një intervistë për kanalin televiziv amerikan MSNBC, Bideni tha se "mbrojtja e Izraelit vazhdon të jetë kritike, nuk ka vija të kuqe që do të më bënin ta ndërprisja furnizimin me municione dhe armatime, pa të cilat ata nuk do të mund të kishin në dispozicion sistemin e mbrojtjes ajrore Kupola e Hekurt për t'u mbrojtur. Por ka një vijë të kuqe që nëse ai dhe ata e kapërcejnë... nuk duhet të kishte mbi 30 mijë palestinezë të vdekur si pasojë e sulmit... ka mënyra të tjera se si mund të veprohet".

Presidenti Biden po e shfaq gjithnjë

e më publikisht zemërimin e tij me Netanyahun, përfshirë edhe mbi politikën izraelite që kanë ngadalësuar dërgimin përmes rrugëve tokësore të ndihmave humanitare, që janë tejet të nevojshme.

Shtetet e Bashkuara u janë bashkuar vendeve të tjera, duke shpërndarë paketa ushqimore në Gazë nëpërmjet ajrit.

Trupat amerikane po i drejtohen Mesdheut për të ndërtuar një port të përkohshëm në bregdetin e Gazës për të bërë të mundur që ndihma të dërgohet në rrugë detare nga Qipro.

Washingtoni vazhdon ta mbështesë Izraelin me ndihmë ushtarake.

Por çfarë mund të ndodhë nëse kryeministri Netanyahu del kundër thirrjeve të Shteteve të Bashkuara dhe ndërmerr ofensivën në Rafah, atje ku janë strehuar më shumë se një milion palestinezë, a do ta ndërpriste Bideni furnizimin e Izraelit me armatime amerikane? "Ne jemi në komunikim me izraelitët mbi këtë çështje. Po vazhdojmë përpjekjet. Nuk do të dal në këtë podium dhe t'i ushqej hipotezat mbi këtë çështje", tha Jake Sullivan, këshilltar për Sigurinë Kombëtare.

Ndërsa afrojnë zgjedhjet presidenciale të muajit nëntor, presidenti Biden synon ta shmangë mundësinë që republikanët t'i marrin votat e përkrahësve të Izraelit.



Por, njëkohësisht, ai duhet të mos lejojë që demokratët progresivë, votuesit e rinj, votuesit myslimanë dhe arabo-amerikanë, ta braktisin për shkak të mbështetjes që presidenti i jep Izraelit.

Kështu që, nëse në ditët e para pas sulmit të Hamasit më 7 tetor ai e përkrahu fort Netanjahun, tani ai po distancohet prej tij. "Duket se ai po bën një shkopitje politike nga Netanyahu", shprehet Laura Blumenfeld nga universiteti "Johns Hopkins".

Qëndrimet e Bidenit duket se nxiten si nga objektivat e tij si në politikën e brendshme edhe në atë të jashtme. "Ndarja e Netanjahut dhe ato që Bideni i cilëson politikën e tij të dëmshme në luftë, nga shteti i Izraelit, në mënyrë që Bideni të vazhdojë ta mbështesë Izraelin, pa sakrifikuar parimet e tij morale", shton ajo.

Së fundmi, anëtarit i kabinetit izraelit të luftës, Benny Gantz, u prit nga ligjvënës demokratë, nënpresidentja Kamala Harris dhe

zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë, një sinjal i mbështetjes së administratës amerikane, në rast se politikani i njohur i qendrës do të bëhej kryeministri i ardhshëm i Izraelit.

Megjithatë, mbetet për t'u parë nëse ndryshimi i qëndrimit të presidentit Biden ndaj kryeministrit Netanyahu do të mjaftojë për t'i qetësuar amerikanët e zemëruar me politikën e kreut të Shtëpisë së Bardhë për luftën në Gazë.

## Anija me ndihma nga Qipro mbërrin në bregdetin e Gazës

**GAZA, 15 MARS** - Një anije e mbushur me ushqim ka mbërritur të premten në bregdetin e Rripit të Gazës, raporton Reuters.

Dërgimi i kësaj anijeje me ndihma u bë për ta testuar dërgimin e ndihmave humanitare përmes detit në enklavën e rrënuar palestineze, e cila është buzë urisë absolute pas një fushate ushtarake pesëmuajore tanimë nga Izraeli.

Anija me gati 200 tonë ushqim pritet të shkarkohet në një dok që po përgatitet në Gazë. Së shpejti pritet ta nisë lundrimin edhe anija e dytë me ndihma.

Nuk ka shumë hollësi se si do të bëhet dërgimi dhe shpërndarja e



ndihmave pasi anija të jetë shkarkuar në bregdetin e Gazës, pasi agjencitë humanitare të

Kombeve të Bashkuara kanë thënë se ka shumë pengesa për dërgimin e ndihmave tek njerëzit

në nevojë.

Nëse rruga e re detare është e suksesshme, ajo do të ndihmojë në lehtësimin e krizës së urisë në Gazë, ku shumica e popullit përballet me kequshqyerje.

Zyrtarët e grupeve humanitare kanë paralajmëruar se Gaza po shkon drejt urisë absolute.

Përfaqësuesi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Gazën dhe Bregun e pushtuar Perëndimor, Richard Peeperkorn, tha në fillim të marsit se një në gjashtë fëmijë nën moshën dyvjeçare në veri të Gazës përballet me kequshqyerje akute.

Në javët e fundit të paktën 15 fëmijë kanë vdekur si pasojë e kequshqyerjes dhe dehidrimit në

spitalin Kamal Adwan në veri të Gazës, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë në enklavën e udhëhequr nga Hamasi - grupi i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe BE-ja.

Lufta vdekjeprurëse e Izraelit në enklavën palestineze nisi pasi pjesëtarët e Hamasit u futën vullshëm në jug të Izraelit më 7 tetor 2023, duke i vrarë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke i rrëmbyer 250 pengje.

Më shumë se 31 000 palestinezë janë vrarë në Rripin e Gazës prej atëherë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze nga ofensiva ajrore, detare dhe tokësore e Izraelit, e cila ka shkaktuar rrënim të madh në enklavë.

## Të paktën 14 të vrarë nga sulmet ruse në Odesa dhe Vinitjsja

**ODESA, 15 MARS** - Të paktën 14 persona janë vrarë dhe dhjetëra janë plagosur pas sulmeve me dronë dhe raketa në rajonet ukrainase të Odesës dhe Vinitjsjas, thanë zyrtarët lokalë më 15 mars. Nderkaq, në rajonin kufitar rus të Belgorodit dhe një rafineri në rajonin Kaluga raportohet se janë

shënjestruar sërish nga dronët dhe raketat. Sulmet me raketa ruse në Odesa lanë të vrarë 14 persona dhe plagosën të paktën 46 të tjerë, tha guvernatori i këtij rajoni, Oleh Kiper, në një postim në Telegram. "Si rezultat i sulmeve ruse me raketa, 14 persona janë vrarë, përfshirë

banorë lokalë, një mjek dhe punëtorë të shpëtimit", tha Kiper, duke shuar se në mesin e 46 të plagosurve, ishin edhe shtatë punëtorë të shpëtimit. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës tha se ka hapur rast për këto sulme, duke shtuar se ka dëme në infrastrukturën civile, ndërtesa dhe makina.



# KQZ-ja iu bashkohet institucioneve zgjedhore të botës për të kundërshtuar zgjedhjet presidenciale të Rusisë në rajonet e pushtuara të Ukrainës

PRISHTINË, 15 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës u është bashkuar thirrjeve të institucioneve zgjedhore nga mbarë bota dhe organizatave të vëzhgimit të zgjedhjeve për t'i dënuar vendimet dhe veprimet e autoriteteve të Federatës Ruse dhe administratave të saj okupuese në lidhje me organizimin e përgatitjes dhe mbajtjes së të ashtuquajturave zgjedhje për president të Federatës Ruse më 15 - 17 mars 2024 në territoret e pushtuara përkohësisht të Ukrainës në Republikën Autonome të Krimesë, qytetin e Sevastopol, Donetsk, Luhansk, Zaporizhzhia dhe rajonet Kherson. KQZ-ja në njërin nga mbledhjet e kaluara është dakorduar për t'i përcjellë KQZ-së së Republikës së Ukrainës një deklaratë mbështetëse, me të cilën mbështet qëndrimin e tyre të datës 23 shkurt 2024, për paligjshmërinë e

organizimit të përgatitjes dhe mbajtjes së "zgjedhjeve" të presidentit të Federatës Ruse të vitit 2024 në territoret e pushtuara përkohësisht të Ukrainës. Në letrën dërguar kryetarit të KQZ-së të Republikës së Ukrainës, Oleh Didenko, theksohet se: "KQZ e Republikës së Kosovës vlerëson se vendimet dhe veprimet e autoriteteve të Federatës Ruse si dhe të administratave të saj pushtuese në lidhje me organizimin e përgatitjes dhe mbajtjes së të ashtuquajturave zgjedhje në këto territore të pushtuara përkohësisht, cenojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Gjithashtu, ato tregojnë mospërfilljen e Rusisë për normat e së drejtës ndërkombëtare, parimet dhe standardet demokratike të njohura botërisht dhe të drejtat themelore të njeriut". Gjithashtu, KQZ-ja vlerëson se



vendimet dhe veprimet e autoriteteve të Federatës Ruse si dhe të administratave të saj pushtuese në lidhje me organizimin e përgatitjes dhe mbajtjes së të ashtuquajturave zgjedhje në këto territore të pushtuara përkohësisht, cenojnë sovranitetin, integritetin territorial

të Ukrainës si dhe tregojnë mospërfilljen e Rusisë për normat e së drejtës ndërkombëtare, parimet dhe standardet demokratike të njohura botërisht dhe të drejtat themelore të njeriut. Duke i kumtuar mbështetjen, KQZ-ja e Republikës së Kosovës shpreh se në një të ardhme të

afër mes dy institucioneve do të ketë bashkëpunime konkrete në fushën e zgjedhjeve. KQZ-ja e Republikës së Kosovës është anëtare me të drejta të plota e Asociacionit të Zyrarëve Zgjedhorë Botërorë (A-WEB) ashtu si edhe KQZ-ja e Republikës së Ukrainës.

## Raporti i KQZ-së: LV-ja mbi dy milionë euro të hyra gjatë vitit 2023, PDK-ja dhe LDK-ja mbi 700 mijë



PRISHTINË, 15 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar të premten raportet e paaudituar financiare të partive politike të vitit 2023. KQZ-ja në njoftimin e bërë për medie thotë se ende nuk është bërë auditimi i këtyre raporteve, prandaj publikimi i tyre shoqërohet me tekstin sqarues: "Këto raporte financiare janë të paaudituar dhe mund të pësojnë ndryshime dhe saktësime gjatë procesit të auditimit". "Pas përfundimit të procesit të auditimit nga auditorët e jashtëm, raportet e audituara do të publikohen në të njëjtën hapësirë në uebfaqen e KQZ-së", thuhet në njoftim. Sipas raportit të publikuar, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, pasuri gjatë vitit 2023 ka

1,475,329.19 euro. Aty përfshihen toka, objekte, pajisjet, raporton "Telegrafi". Kurse gjithsej të hyra për vitin 2023, LV-ja ka pasur mbi 2 milionë euro (2,098,592.49). Raporti për PDK-në thotë se kjo parti në vitin 2023 pasuri ka 27,053.46 euro. Te pjesa e të hyrave dhe shpenzimeve, bëhet me dije se PDK-ja në vitin 2023 ka pasur 808,983.00 euro të hyra vjetore. Tek subjekti tjetër opozitar, LDK-ja, bëhet me dije se pasuri afatgjatë ka 38,427.99 euro. Të hyra brenda vitit 2023, LDK-ja ka pasur 723,169.92 euro. Raporti i KQZ-së për pasqyrën financiare thotë se AAK-ja ka pasuri 37,759.98 euro. Ndërsa të hyra në vitin 2023 AAK-ja ka pasur 280,000.00 euro.

## Konjufca: Gratë kanë dhënë kontribut e shembull të jashtëzakonshëm

PRISHTINË, 15 MARS - Në Kuvendin e Kosovës është mbajtur të premten seanca shënjuese me ish-deputetet e legjislaturave të mëparshme. Aty u vlerësua lart roli dhe kontributi i ish-deputeteve ndër vite. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka theksuar se gratë kanë dhënë kontribut e shembull të jashtëzakonshëm. "Në këto ditë si sot nuk mund të mos i kujtojmë gratë intelektuale. Në historinë e re të Kosovës numri i grave të angazhuara politikisht është rritur vazhdimisht dhe roli i tyre është i pazëvendësueshëm", ka deklaruar Konjufca.

Në seancë ishin ish-deputetet Kaqusha Jashari, Flora Brovina, Besa Gaxherri e shumë të tjera. Ish-deputetja Flora Brovina ka thënë se rruga deri tek këto ulëse nuk ka qenë e lehtë. "Askush nuk na i dhuroi këto ulëse sepse jemi gra, por ishte dëshira të marrim pjesë në çdo lëvizje", ka theksuar ajo. Ish-deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, u shfaq në foltore me një bluzë mbi të cilën ishte fotografia e të ndjerës Liridona Ademajt e cila u vra muaj më parë. "Në memorien time dua të kthej tri momente të grupit të grave deputete. Kur jemi

bërë bashkë ka pasur momente kur unë, përkundër grupit tim parlamentar, kam votuar diçka tjetër se ka qenë në interes të gruas. Për herë të parë është ndarë buxhet me propozimin e grave, e unë dua t'i falënderoj ato që kanë filluar e krijuar këtë grup duke iu dalluar historia që keni dhënë", ka thënë Haxhiu. Ajo përmendi vrasjen e Liridona Ademajt duke thënë se edhe sot e kësaj dite ndihet e trishtuar nga ajo ngjarje që pasqyron realitetin në vend. "Jorastësisht vendosa ta përmend këtë rast në këtë takim, kur këto



ngjarje janë shndërruar në dukuri. Nuk duhet të lejojmë që kjo dukuri të lëshoj rrënjë, nuk mund të mendohet një shoqëri demokratike kur ka

ngjarje të tilla, andaj të nderuara deputete, kudo që jeni, ta rritim përgjegjësinë që kemi", ka thënë ish-deputetja Haxhiu.



# Escobari: Kurti refuzoi propozimet për dinarin, po kemi vështirësi me këtë qeveri

Zëvendësi i ndihmësit të sekretarit amerikan të Shtetit, Gabriel Escobar, tha se nuk ka arritur ta bindë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta pezullojë vendimin për ndalimin e monedhës serbe në Kosovë, derisa Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Qeveria e Kosovës të gjejnë një zgjidhje afatgjatë, siç do të ishte transferimi elektronik i eurove përmes sistemit të Kosovës. “Kryeministri tha se ky ishte vendim i një institucioni të pavarur”, tha Escobari në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë” të premtën, në përfundim të vizitës së tij në Kosovë, të cilën e nisi më 13 mars

**PRISHTINË, 15 MARS** - Zëvendësi i ndihmësit të sekretarit amerikan të Shtetit, Gabriel Escobar, tha se ende shpreson që një zgjidhje për dinarin të gjendet të martën, kur kryenegociatorët e Kosovës dhe atë të Serbisë të takohen në Bruksel. Ai shtoi se nuk ka marrë asnjë garanci nga kryeministri i Kosovës kur bëhet fjalë për ta çuar përpara draft-statutin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Escobari pranoi se ka, siç tha, “shumë zhgënjim me këtë qeveri të Vetëvendosjes, jo vetëm në Uashington, por edhe në Bruksel, Romë, Berlin e Paris”. “Ne gjithmonë do të jemi miq të ngushtë të Kosovës, por kjo nuk do

të thotë se nuk do të kemi dallime me individë dhe me qeveri individuale. Dhe, unë mendoj se pikërisht këtu jemi tani - jemi duke hyrë në një periudhë të mungesës së komunikimit. Dhe ne, së paku nga pala amerikane, jemi duke bërë gjithçka që mundemi për ta riparuar këtë marrëdhënie”, tha Escobari, njëherësh i dërguar i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor. Vendimin për tokat rreth Manastirit të Deçanit ai e cilësoi pozitiv, por tha se janë edhe dy kushte që Kosova duhet t'i plotësojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës. I pyetur nëse ShBA-ja sheh ndonjë lidhje midis sulmit në Banjskë dhe shtetit të Serbisë, Escobari tha: “Ne mendojmë se ka pasur disa lidhje

financiare dhe organizative, por po e hetojmë në tërësi”. “Ne nuk po i kërkojmë Serbisë hetime të 24 shtatorit [kur ndodhi sulmi në Banjskë], ne po i kërkojmë llogaridhënie”, tha Escobari.

*Z. Escobar, faleminderit që po flisni për Radion Evropa e Lirë këtu në Prishtinë, në fund të vizitës suaj në Kosovë! Para se të udhëtonit për në Kosovë, ju thatë se fokusi i vizitës do të ishte në një zgjidhje të mundshme për, siç thatë ju, vendimin e pakoordinuar për ta ndaluar dinarin serb. Mbrëmë, pas takimit me kryeministrin e Kosovës, ju tingëllyuat paksa optimist lidhur me atë takim. Thatë se e kishit një diskutim të mirë, të hapur, ku kryeministri Kurti tha se ai do t'i shqyrtonte disa propozime që ju ia dhatë. A keni marrë ndonjë përgjigje nga kryeministri?*

**Escobar:** Kemi, por më lini t'ju tregoj pse kjo është e rëndësishme. Shtetet e Bashkuara janë shumë të përkushtuara për t'u siguruar që Kosova mbetet një demokraci civile multietnike dhe, për të ndodhur kjo gjë, të gjitha komunitetet etnike duhet të ndihen të sigurta dhe të jetojnë në kushte sigurie dhe dinjiteti. Ajo që po ndodh tani me vendimin e Bankës Qendrore [të Kosovës], është se ka shumë qytetarë tuaj që po ndiejnë shumë

dhimbje, njerëz që nuk po i marrin pagat modeste. Ne po flasim për [person] me aftësi të kufizuara, të pensionuar, studentë - njerëzit më të cenusur - dhe ky vendim i ka prekur ata shumë thellësisht. Tani, qeveria ka thënë se ka shumë opsione për ta, por qeveria nuk ua ka ofruar atyre një opsion. Qeveria ka thënë se opsioni... [se] ata e kanë vetë përgjegjësinë për ta bërë këtë dhe shumë njerëz janë duke e pasur të vështirë.

Disa nga njerëzit më të moshuar nuk i kanë dokumentet e duhura. Disa nga njerëzit më të rinj... dokumentet e tyre nuk po pranohen. Disa nga bankat po thonë se duhet mesatarisht një orë për ta hapur një llogari. Jo të gjithë kanë llogari. Vetë bankat, pavarësisht se çfarë thotë Ministria juaj e Financave... vetë bankat thonë se atyre iu duhen mes 30 dhe 40 mijë llogarive, me secilën llogari që merr nga një orë. Kjo është 40 mijë orë të kohës së stafit. Duke konsideruar se njeriu mesatar punon mes 1 000 dhe 1 500 orësh në vit, imagjoni se sa gjatë do të duhet për t'i hapur këto llogari. Kështu që, ky veprim, i cili është i pakoordinuar dhe që ka krijuar përçarje, është duke krijuar vështirësi reale për qytetarët, për

disa nga qytetarët e Kosovës.

Tani njerëzit që nuk marrin ndihma sociale nga Serbia, nuk e vërejnë se sa shumë po ndikon te disa. Ata që punojnë me euro dhe ata që paguhen në mënyra të tjera, nuk e kuptojnë se ka njerëz në mesin tuaj që po vuajnë.

Kështu që ishte mirë që kryeministri e pranoi se ka njerëz që po vuajnë. Por, kjo nuk mjafton. Na duhet një zgjidhje. Unë i kërkoja kryeministrit ta suspendojë vendimin përderisa ne, bashkë me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Qeverinë e Kosovës, punojmë për një zgjidhje më afatgjatë, që u përshtatet nevojave tuaja, pra transfereve elektronike në euro përmes sistemit të Kosovës. Por, tani, ne duhet të bëjmë diçka urgjente. Fatkeqësisht, nuk pata sukses për ta bindur atë për këtë.

*Ky është lajmi i fundit nga kryeministri?*

**Escobar:** Ky është lajmi i fundit.

*So?*

**Escobar:** Unë ende jam duke shpresuar që, derisa kryenegociatorët do të takohen në Bruksel të martën, ata do ta gjejnë një zgjidhje të menjëhershme për t'i lejuar transferet e parave të gatshme në euro për këta njerëz.





## LDK-ja akuzon LV-në se po manipulon me të dhënat për tenderët njëburimorë

PRISHTINË, 15 MARS - Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, Berat Rukiqi, e ka akuzuar partinë në pushtet se po manipulon me shifra pas disa të dhënave që publikuan një ditë më parë lidhur me tenderët njëburimorë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilat i paraqiti fillimisht ministri Liburn Aliu. Në postimin e Lëvizjes Vetëvendosjes thuhet se nga buxheti i kësaj ministrie për tri vjet, vetëm 0.04 për qind janë kontrata njëburimorë. Rukiqi ka thënë se këtu është

manipuluar meqë është marrë vetëm pjesa e planifikimit hapësinor dhe jo pjesa e infrastrukturës, ku thotë se vlera e tenderëve njëburimor është 10 milionë euro dhe se ku janë 54 kontrata me një ofertues të vetëm. "Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor kanë qenë dy ministri të ndara, të cilat në këtë formacion qeverisës, janë fuzionuar në një ministri të vetme. Te ekspozuar, me hajni milionëshe përmes tenderëve njëburimor, zyra e propagandës e partisë në pushtet, e merr dhe

vendos në grafikon, vetëm pjesën e planifikimit hapësinor, që është vetëm një pjesë e ministrisë dhe e bën inekzistente pjesën tjetër të ministrisë, përkatësisht pjesën e infrastrukturës (tenderët e rrugëve). Te kjo pjesë, vlera e tenderëve njëburimor është 10 milionë euro (54 kontrata me një ofertues të vetëm)", ka shkruar Rukiqi në "Facebook". Ai e ka akuzuar LV-në edhe për manipulim për të dhënat e publikuara lidhur me tenderët njëburimorë në tri komuna që udhëhiqen nga opozita.



## Vdekja e Astrit Deharit dhe sulmi në Banjskë, KMDLNj-ja thotë se nuk pret që asnjëri rast të sqarohet për shkak të politikës

PRISHTINË, 15 MARS - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka publikuar një reagim publik në lidhje me sulmin në Banjskë dhe për vrasjen e Astrit Deharit. Ky këshill ka theksuar se nuk pret që asnjëri nga këto dy raste të sqarohet deri në fund për shkak të ndërhyrjes dhe interesave krejtësisht politike. "Më 22 shtator 2024, grupe të armatosura në Veri të Kosovës sulmuan policinë e Kosovës dhe vranë rreshterin Afrim Bunjaku. Sipas dëshmime të filmuara këto grupe udhëhiqeshin nga Milan Radojiçiq, i angazhuar në strukturat paralele policore dhe paramilitare në veri të Kosovës, që nga përfundimi i luftës. Në kohën e sulmit kundër policisë së Kosovës, Radojiçiq ishte nr. 1 përkrah ndikimi në Listën Serbe dhe një kohë edhe nënkryetar i saj", është thënë në reagim.



Sipas KMDLNj-së, ky sulm është gjykuar nga të gjithë dhe është cilësuar si sulm terrorist, "mirëpo ndaj shtetit serb apo udhëheqësve të lartë serb nuk u ndërmarrë asnjë masë apo veprim kufizues apo ndëshkues". "Politikanët kosovarë, në vend se të angazhohen për hetime profesionale, të pavarura dhe të pandikuara, këtë sulm u përpoqën ta përkthejnë në mundësi që, përmes marketingut folklorik të përfitojnë politikisht. Ndërkombëtarët prisnin një raport të kompletuar dhe të mbështetur në fakte ndërsa

ministri dhe papërgjegjshëm dhe të hendikepuar profesionalisht organizonin sfilatamediale duke komprometuar procesin e hetimeve që në fillim. Në të njëjtën kohë, për të shtuar presionet politike mbi Prokurorinë Speciale të Kosovës me të vetmin qëllim që ta fusin nën kontroll, kërkoni nga Prokuroria Speciale që të ngritin aktakuzë kundër Milan Radojiçiqit duke deklaruar se provat janë në Zyrën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale, pa dhënë asnjë sqarim se si Radojiçiq, bashkë me grupin e armatosur u lejua të tërhiqej nga Kosova, pa ther në këmbë në kohën kur ishin cak shumë i lehtë për neutralizim nga Policia e

Kosovës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Më tutje, KMDLNj-ja ka thënë se refreni i udhëheqësve më të lartë politikë kosovarë ishte: "pse ndaj Serbisë nuk po merren masa ndëshkuese për sulmin në Banjskë... thuaja që ndërkombëtarët janë këtu për t'i plotësuar dëshirat e tyre...". "Ambasadori i BE-së në Kosovë dhe zëdhënësi i BE-së deklaruan se janë në pritje të një raportit nga pala kosovare për rastin e Banjskës por që deri më tani ai raport mungon dhe se nuk mund të marrin asnjë vendim duke u mbështetur vetëm në deklaratat mediale të individëve, duke menduar këtu në ministrin e Punëve të Brendshme dhe një pjesë e stafit

të tij që u shndërruan në jpe mediatike duke dëmtuar pariparueshëm hetimet për këtë rast", është thënë në këtë reagim. KMDLNj-ja ka vlerësuar se "këta dy zyrtarë të lartë të BE-së deklaruan se hetimet për këtë rast mund të zgjasin me vite duke iu referuar edhe palës kosovare". "Në këtë rast, sulmi kriminal dhe terrorist në Banjskë, nga një rast tipik kriminal, me fajin e një pjese të padijshme të politikanëve kosovarë u shndërrua në çështje politike. Paralelisht me këtë, në mënyrë të paskrupull, nga një segment i ndjeshëm i politikës kosovare u manipulua me rastin Dehari duke shkatërruar disa prova që ishin në Institutin e

Mjekësisë Ligjore në Prishtinë të cilit, me dy raste, ose u bënë përpjekje për t'i vjedhur ato prova (ndoshta edhe janë vjedhur) ose, duke përdorur metoda radikale për asgjësim përmes zjarrëvënies, asnjëherë të sqaruar për opinion. Ndërkombëtarët me kujdes e kanë përcjellë manipulimin me rastin Dehari andaj po mbahen të rezervuar edhe për rastin e sulmit terrorist në Banjskë. Prandaj po kanë dyshime dhe rezerva", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se "futja e Radojiçiqit dhe të tjerëve për sulmin në Banjskë në listën e Interpolitit më shumë e shfaqëson Serbinë se që ka për qëllim që ky rast të zbardhet pas së cilës do të sanksionohet Serbia për të cilën ndërkombëtarët janë të interesuar ta nxjerrin nga kjo situatë". "Me deklarata dhe manipulime politike nuk mund të kërkohet dhe sigurohet drejtësi për rastin Dehari dhe as përgjegjësi për rastin e sulmit terrorist në Banjskë. KMDLNj nuk pret që asnjëri nga këto dy raste të sqarohet deri në fund për shkak të ndërhyrjes dhe interesave krejtësisht politike. Këtyre as që iu konvenon që këto raste të zbardhen për t'u mos përballur me përgjegjësinë konkrete, që, pa asnjë dyshim edhe e kanë. Dikush, për shkak të oportunitetit politik qartazi nuk po e thotë apo po e fshehtë të vërtetën ose në marrëveshje po e bëjnë këtë. Opinioni në Kosovë po mbetet i hutuar, në mungesë të informatave", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

## BE-ja konfirmon se në raundin e ri të dialogut do të bisedohet për dinarin

PRISHTINË, 15 MARS - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka konfirmuar të premten se blloku e ka caktuar një takim për të martën e ardhshme, më 19 mars, në kuadër të

dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel të kryenegociatorëve. Stano tha se në takim, i cili zhvillohet në Bruksel, do të bisedohet për çështjen e dinarit serb, përdorimin e të

cilit autoritetet e Kosovës e ndaluan përmes një rregulloreje të re për valutën që hyri në fuqi në shkurt. "Do ta kemi takimin e radhës në kuadër të dialogut të martën. Janë ftuar për këtë takim

kryenegociatorët për t'i vazhduar diskutimet aty ku kishim mbetur pas takimit të fundit", tha Stano. Kryenegociator i Kosovës është Besnik Bislimi, ndërsa i Serbisë është Petar Petkoviç.



# Ishte në shfrytëzim nga AAK-ja, Ministria e Bujqësisë rikthen objektin me mbi 600 metra në Prishtinë

**PRISHTINË, 15 MARS** - Objekti i cili ishte në shfrytëzim nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, prej 600 metrash, i është rikthyer Ministrisë së Bujqësisë. Kështu ka njoftuar të premtën ministri i Bujqësisë, Faton Peci, i cili ka thënë që së shpejti fillojnë procesin e renovimit. "I rikthyem mbi 600 metra katrorë në shërbim të titullarit - Ministrisë së Bujqësisë! Sot vizitova hapësirat e objektit të Ministrisë së Bujqësisë në Lagjen Ulpiana në Prishtinë, ku kemi rikthyer mbi 600 metra katrorë në shërbim të institucionit. Së shpejti do të fillojmë procesin e renovimit. Mbetem optimist se instancat e sistemit të drejtësisë do të marrin një vendim meritor që objekti i ministrisë dhe hapësirat përreth saj të jenë në

shfrytëzim dhe shërbim për titullarin dhe, njëherësh, të mundësohet zbatimi i vendimit tim si ministër i marrë me datë 22.08.2023", ka shkruar Peci në "Facebook". Pas këtij njoftimi të ministrit Peci ka reaguuar AAK-ja. Partia e Ramush Haradinajt e ka quajtur Pecin mashtrues ordiner, duke thënë se AAK-ja ka kontratë me Ministrinë e Bujqësisë për vetëm 569 metra katrorë. "AAK-ja ka kontratë me Ministrinë e Bujqësisë për një pjesë të objektit. Ne paguajmë qira mujore për shfrytëzimin e 569 metra katrorë, në katin përdheshë dhe të parë në vlerë prej 4552 eurosh në muaj, ku nuk përfshihet as bodrumi e as kati i dytë, që janë të mbyllura e të lëna në gjendje të mjerueshme.



Pohimet e këtij far ministrit se goja 'I rikthyem mbi 600 metra katrorë në shërbim të titullarit...', janë pjesë e manipulimit ordiner të tij për të krijuar përshtypjen sikur ato paskan qenë të

uzurpuara nga dikush. Nuk është hera e parë që Peci bën manipulime të kësaj natyre me qëllim që ta luftojë politikisht Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, sepse edhe ashtu i kanë

mbetur pak ditë aty ku është. Ne jemi përpjekur që të jemi të kujdesshëm e të mos hapim debat publik dhe marrëdhëniet kontraktuale t'i kryejmë siç bëjnë subjektet e përgjegjshme, e të pranojmë të paguajmë një qira që është mbi vlerën e tregut, për një objekt që e ka renovuar Aleanca me mjete të veta, por këtë herë nuk mund mos të themi se Faton Peci është një manipulues ordiner. Aleanca është në shtëpi të vet dhe aty do të qëndrojë pavarësisht a i pëlqen dikujt apo jo. Me qëllimin më të mirë që mediet dhe qytetarët të mos bien pre e këtyre mashtrimeve, po i publikojmë disa fotografi të hapësirës së pretenduar se i qenka rikthyer ministrisë si dhe kopjen e kontratës së qirasë për shfrytëzim", është thënë në reagimin e AAK-së.

# Në cilat vende të Evropës janë ngritur më së shumti çmimet e pronave që nga viti 2015?

**PRISHTINË, 15 MARS** - Çmimet e shtëpive janë rritur me më shumë se 166 për qind që nga viti 2015 në Hungari, por ka një vend me rritje edhe më të lartë. Çmimi i një apartamenti në Stamboll tani është në konkurrencë të ngushtë me çmimet e qyteteve të shtrenjta si Parisi dhe Londra, pasi shifrat tregojnë se çmimet e banesave turke janë 12 herë më të larta sesa ishin nëntë vjet më parë në terma nominalë. Ndër vendet anëtare të OECD-së, shtetet e Evropës veriore si Suedia dhe Finlanda kanë parë ndryshimin më të vogël, me më shumë se 4 për qind rritje në çmimet nominale të banesave që nga viti 2015. Në anën tjetër të shkallës qëndron Turqia, e cila ndiqet nga Hungaria, ku çmimet janë 166 për qind më të larta sesa ishin në 2015, raporton "Euronews". Shumica e vendeve të OECD kanë çmimet e banesave të tyre të rriteshin në dyshifrorë midis 2015 dhe 2023. Megjithatë, çmimet turke dallohen edhe shkaku i numrit të madh të blerësve rusë, duke i ngritur edhe çmimet e



qirave aq lart, sa që edhe guvernatori i Bankës Qendrore të vendit nuk mund t'i përballojë. Megjithatë, ndërsa çmimet e banesave turke janë rritur gradualisht që nga viti 2015, ato filluan të rriten me shpejtësi të madhe në vitin 2021. Ata arritën kulmin e tyre në vitin 2022, kur çmimet e banesave u rritën 168 për qind në një vit, e ndjekur nga një rritje prej 76-përqindësh në vitin 2023. Ndërkohë, në të gjithë Evropën dhe ShBA-në, çmimet e banesave u goditën në fund të vitit 2022 pasi bankat qendrore në këto ekonomi filluan t'i rritin normat e interesit për ta trajtuar inflacionin e lartë, i cili rriti normat e hipotekave në proces. Nga ana tjetër, Banka Qendrore e Turqisë uli normën e saj bazë në gusht të vitit 2022, edhe pse në nëntor të atij viti inflacioni në

vend ishte afër 85 për qind. Ekspertët e vlerësojnë përshkallëzimin në rritje të çmimeve nominale të pronave në Turqi në një përzjerje arsyesh. "Ndryshimi aktual fillon nga viti 2020", tha Gorkem Yapan, udhëheqës i sektorit të pasurive të paluajtshe dhe ndërtimi për tregun turk në KPMG. "Arsyet kryesore besoj se janë luhata e monedhës, zhvlerësimi i lirës turke, normat më të larta të inflacionit dhe rritja e kostove të ndërtimit, si dhe kërkesa në rritje pas pandemisë", shtoi ai. Norma e inflacionit në shtetin turk në vitin 2022 ishte jashtëzakonisht e lartë, më shumë se 50 për qind për pothuajse të gjithë vitin, duke arritur mbi 80 për qind në muajin tetor. Megjithatë, çmimet reale të banesave (të rregulluara për inflacionin) gjithashtu u rritën 96.7 për qind deri në tremujorin e tretë të 2023-s krahasuar me vitin 2015, sipas OECD. "Ne përjetuam tërmete gjatë vitit të kaluar, ku u prekën 11 qytete, të cilët shkaktuan rritjen e çmimeve, sepse njerëzit duan të jetojnë në vende më të sigurt si ndërtesat

rezistente ndaj tërmeteve", tha Yapan. Ndërsa blerësit me para të gatshme vërshuan tregun, njerëzit me hipoteka në Turqi kanë parë që normat e tyre mujore të rriten në qiell: nivelet ekstreme të inflacionit në Turqi, i cili kohët e fundit arriti pothuajse në 70 për qind, nxiti Bankën Qendrore ta shtrejngonte në mënyrë agresive politikën e saj monetare dhe ta rriste normën bazë nga 8.5 për qind në muajin qershor të vitit 2023, në 45 për qind në janar 2024. Si rezultat, hipotekat në Turqi tani kanë një interes vjetor prej 40-përqindësh. Gjithashtu, maksimumi i hipotekës për rëmbim mbulon jo më shumë se një të pestën e çmimit të një shtëpie. Gjatë gjithë vitit 2023 më pak se 15 për qind e shtëpive të shitura kishin një blerës me hipotekë. Pjesa tjetër iu shit blerësve me para në dorë. Tregu turk është frenuar si pasojë e çmimeve të larta të banesave dhe qirave, normave të larta të interesit dhe rënies së të ardhurave të familjeve në terma realë për shkak të inflacionit të lartë.

Çmimet e banesave janë ende në rritje në terma nominalë, por ato po bien prapa inflacionit. Prandaj, në terma realë, kohët e fundit ato janë bërë më të lira. Kostot e larta të ndërtimit mund të çojnë në furnizim të kufizuar. Megjithatë, nëse kërkesa për shtëpi rritet dhe normat e interesit bien për ta stimuluar rritjen, kjo mund të ndihmojë në kapërcimin e stagnimit aktual. Megjithatë, njerëzit nuk mund ta përballojnë blerjen e shtëpisë së tyre për momentin, duke shkaktuar në çmime kokëfortë të larta të qirave dhe kjo, në fakt, po u lë blerësve hapësirë për të investuar me para në dorë. "Ka një raport, për shembull, në Stamboll ose në Turqi", shpjegoi Yapan. "Shumicën e herëve çmimi i shitjes së një shtëpie ishte 300 herë më i lartë se qiraja. Është një mesatare. Por, tani qiratë janë shumë të larta", pohoi ai. "Rritja e qirasë është më shumë se rritja e çmimit të banesave. Kështu që tani kjo mesatare bie midis 250-300", përfundoi Yapan. Në teori, kjo do të thotë se, në më pak se 300 muaj (25 vjet), investitorët mund ta rikuperojnë çmimin e një shtëpie.

# INDEP: Konsumatorët po përballen me sfida nga aplikimi i padrejtë i Inteligjencës Artificiale nga kompanitë

**PRISHTINË, 15 MARS** - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në bashkëpunim me anëtarët e Këshillit të Mbrojtjes së Konsumatorit, të premtën shënuan Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Konsumatorit. Sipas INDEP-së, konsumatorët janë të detyruar t'i pranojnë politikën dhe kushtet e vendosura nga kompanitë ndërsa, nga ana tjetër, përdorimi i Inteligjencës Artificiale pa kritere të qarta dhe pa marrë parasysh etikën dhe zbatimin e ligjit, përbën shkelje

të të drejtave të konsumatorëve dhe cenon besimin në teknologji. Aty u tha se konsumatorët në Kosovë po përballen me sfida të ndryshme që rrjedhin nga aplikimi i papritur dhe i padrejtë i teknologjive të Inteligjencës Artificiale nga kompanitë, duke ndikuar në privatësinë, të drejtat e tyre dhe mungesën e transparencës. Drejtori i Programit të INDEP-së, Dardan Abazi, bëri me dije se që pesë vjet INDEP-ja shënon Ditën e Konsumatorit, teksa tha

se në panel diskutimi do të jetë tema për Inteligjencën Artificiale, hovi i zhvillimit të saj dhe roli në të drejtat e konsumatorit. "Inteligjencia artificiale është një mjet që dikush mund ta përdorë për keq dhe në fund konsumatori është ai që dëmtohet", tha Abazi. Zëvendësministri i Ministrisë, Tregtisë Industrisë dhe Ndërmarrësisë, Mentor Arifaj, tha se mbrojtja e konsumatorit ka të bëjë me krijimin e një ambienti të sigurt për nevojat ekskluzive cilësore për ta. "Sot




shënojmë Ditën Ndërkombëtare të Konsumatorit për t'i garantuar të drejtat e konsumatorit në botë. Është detyrë e jona që ata të trajtohen drejt dhe me integritet. Duhet të punojmë për t'i luftuar mashtrimet

potenciale për t'i mbrojtur nga abuzimet dhe mashtrimet", tha ai. Arifaj shtoi se si Ministria e kanë dërguar në Kuvend Projektligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorit, por ende nuk është votuar. "Ky projektligj synon praktikën tregtare, kushtet e padrejta, blerjet e ndryshme digjitale, masat mbrojtëse, ka për interes t'i mbrojtë interesat e konsumatorit si dhe ka të bëjë me qarkullimin e lirë të mallrave në treg", tha Arifaj.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Foda publikon listën, risi rikthimi i Zhegrovës dhe pesë lojtarë nga Superliga

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 15 MARS** - Përzgjedhësi i ri i Përfaqësueses së Kosovës, Franco Foda, e ka publikuar listën e futbollistëve të cilët do t'i ketë në grumbullim për dy miqësoret e rëndësishme të këtij muaji kundër Armenisë, më 22 mars dhe kundër Hungarisë, më 26 mars. Në listën e Fodës janë përfshirë 24 futbollistë, por edhe Lindon Emërllahu (FC Ballkani), pas angazhimit me Përfaqësuesen U21 në ndeshjen kundër Gjermanisë, nga data 23 mars do t'i bashkohet Përfaqësueses A për ndeshjen e

dytë kundër Hungarisë. Këto dy miqësore janë sfidat e para të Kosovës nën drejtimin e trajnerit gjerman, bashkë me stafin e tij. "Dardanët" do të grumbullohen të hënën (më 18 mars) në hotel "Emerald", teksa stërvitjen e parë do ta zhvillojnë në të njëjtën ditë në orën 16:00, në Kampin Nacional në Hajvali. Paraprakisht, të hënën, në orën 12:00, në hotel "Emerald" do të mbahet konferencë për media e përzgjedhësit Foda. Ndërkohë, të mërkurën ekspedita e Kosovës do të niset për në Yerevan, atje ku të premtën do ta zhvillojë përballjen me Armeninë. Pas kësaj ndeshje "Dardanët" do të



zhvendosen në Budapest, për testin e dytë të këtij muaji kundër Hungarisë. Këto dy miqësore do të jenë mundësi e mirë për trajnerin Foda që ta njohë nga

afër ekipin dhe ta përgatisë atë për një rrugëtim të suksesshëm. Emrat e rinj të ftuar nga Foda janë Drilon Hazrollaj dhe Ilir Avdyli, ndërsa vërehet edhe

**LISTA E FUTBOLLISTËVE**

A. Muriq, V. Bekaj, I. Avdyli, A. Rrahmani, F. Aliti, L. Dellova, M. Kryeziu, L. Paqarada, I. Krasniqi, M. Vajvoda, F. Hadergjonaj, D. Rudhani, F. Loshaj, F. Muslija, B. Idrizi, V. Berisha, B. Celina, M. Rashica, E. Zhegrova, Z. Bytyqi, E. Rashani, D. Hazrollaj, A. Rrahmani, V. Muriqi.

Lista rezervë: Mustafë Abdullahu, Kreshnik Hajrizi, Lirim Kastrati, Qendrim Zyba, Altin Zeqiri, Emir Sahiti, Shkelqim Vladi, Muhamet Hyseni.

rikthimi i Edon Zhegrovës. Nga Superliga e Kosovës në listë janë edhe Lumbardh Dellova e Ilir Krasniqi, duke çuar në pesë numrin e të ftuarve.

## Mungojnë Daku dhe Muja në listën e Sylvinhos, ftohet Hoxha

**TIRANË, 15 MARS** - Kombëtarja shqiptare do të luajë dy takime miqësore ndaj Kilit (22 mars) dhe Suedisë (25 mars). Përgatitjet për këto dy ndeshje do të nisin të hënën, më 18 mars, teksa trajneri Sylvinho ka publikuar edhe listën me plot 26 lojtarë të grumbulluar. Risi në këtë listë është emri i Arbër Hoxhës, i cili duket se e ka zgjedhur Shqipërinë. Ndërsa nuk janë ftuar në këtë grumbullim Mirind Daku dhe Arbnor Muja, që kishin qenë në dy grumbullimet e fundit të fazës kualifikuese për

"Euro 2024". Grumbullimi i lojtarëve do të nisë që të dielën në Tiranë me futbollistët që do të përfundojnë më herët impenjimet me skuadrat e tyre, ndërsa grupi i lojtarëve do të jetë i plotë të hënën më 18 mars. Seancat stërvitore do të zhvillohen në "Shtëpinë e Futbollit", ndërsa të enjten kuqezinjët do të udhëtojnë drejt Parmës, aty ku më 22 mars do të luhet edhe ndeshja e parë miqësore ndaj Kilit në stadiumin "Ennio Tardini", duke nisur nga ora 20:45. Pas sfidës me Kilin,

Kombëtarja do të luajë një tjetër përballje miqësore me Suedinë. Kjo ndeshje do të zhvillohet më 25 mars në stadiumin "Friends Arena" të Stokholmit në Suedi në orën 19:00.

**LISTA E FUTBOLLISTËVE**

E. Berisha, Th. Strakosha, E. Kastrati, E. Hysaj, I. Balliu, B. Gjimeshi, E. Mihaj, F. Veseli, J. Mersinaj, M. Kumbulla, M. Mitaj, N. Aliji, Y. Ramadani, K. Asllani, Q. Laçi, K. Bare, N. Bajrami, T. Seferi, M. Uzun, E. Muçi, J. Asani, A. Muçolli, S. Cikalleshi, R. Manaj, A. Broja, A. Hoxha.



## Fundjava, me përballje interesante në basketboll



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 15 MARS** - Në këtë fundjavë do të zhvillohen ndeshje interesante në kuadër të xhiros së 25-të në Prince Caffè Superligë. Sot (e shtunë) nga ora 17:00 në Gjakovë do të përballen Vëllaznimi - Trepça. Gjakovarët që e kanë siguruar "play-off"-in janë në vendin e pestë dhe do të përpiqen ta mposhtin kryesuesen e elitës, Trepçën, që tashme e ka siguruar vendin e parë. Skuadra nga Gjakova numëron 11 fitore e 13 humbje, kurse ajo nga Mitrovica 22 fitore e dy humbje.

Ndërsa nga ora 19:00 do të zhvillohet dueli tjetër në mes të Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Kampionët e Kosovës renditen në vendin e dytë me 17 fitore e shtatë humbje, kurse therandasit janë në pozitën e tretë me 15 fitore e nëntë humbje. Duel shumë i vlefshëm është ai i së dielës mes dy skuadrave prizrenase, Proton Cable Prizrenit dhe Bashkimit, që renditen në vendin e shtatë, përkatësisht të gjashtë. Prizreni ka shtatë fitore dhe 17 humbje, kurse "Portokallezinjtë" nëntë fitore dhe 15 humbje, andaj është një sfidë direkte që dërgon në garat e "play-off"-it. Po të dielën do të zhvillohet

dueli ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Istogut. "Bardhekaltrit" momentalisht janë në vendin e katërt me 14 fitore dhe dhjetë humbje, kurse istogasit janë në vendin e fundit me një fitore e 24 humbje.

**SUPERLIGA - Java 25**

Të shtunën takohen:  
17:00 Vëllaznimi - Trepça  
19:00 Peja - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:  
20:00 Proton Cable Prizreni - Bashkimi  
19:00 Sigal Prishtina - Istogu

## Gjysmëfinalja e Kupës: Suhareka - Ballkani dhe Drita - Prishtina

**PRISHTINË, 15 MARS** - Të premtën në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) është bërë hedhja e shortit për çiftet e

gjysmëfinaleve të Kupës së Kosovës. Por, tashmë janë mësuar çiftet e gjysmëfinaleve të cilat do të zhvillohen me sistemin

vajtje-ardhje. Në ndeshjen e parë do të luhet derbi lokal në mes të Suharekës dhe Ballkanit. Megjithatë, në ndeshjen e dytë do të jetë më

interesante pasi do të ndeshen Drita dhe Prishtina. Ndeshjet e para do të zhvillohen më 3 prill, ato kthyes më 17 prill.



## Skrijelaj, 'Ylli i javës' në Superligë: Shpresoj të vazhdojmë me rezultate të mira

**PRISHTINË, 15 MARS** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 25-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të KF Fushë-

Kosova, Alden Skrijelaj, i cili ishte golashënues i dyfishtë në ndeshjen kundër kampionit dhe liderit aktual, Ballkanit, me çka ishte edhe vendimtar në fitore si dhe me një paraqitje të mirë gjatë gjithë ndeshjes. Pasi

mori këtë çmim futbollisti i KF Fushë-Kosova u shpreh i lumtur që për herë të parë u vlerësua si më i miri i javës. "Jam i lumtur dhe do të thotë shumë për mua që mora këtë çmim. Do të doja të falënderoja

të gjithë, nga shokët e skuadrës deri te trajneri. Shpresoj që të ketë më shumë çmime të tilla dhe mbi të gjitha të vazhdojmë me rezultate të mira si skuadër", ka thënë Skrijelaj për faqen zyrtare të FFK-së.



# Përballje të zjarrta në Ligën e Kampionëve, spikat sfida Real - City



### "Epoka e re"

**NYON, 15 MARS** - Me tetë ekipet më të mira në Evropë ishte e pashmangshme që goglat do të rezervonin përballje të forta. Faza çerekfinale e Ligës së Kampionëve pritet të jetë fantastike, pasi goglat përplasën favoritët ndërmjet tyre: Bayern Munchen do të përballlet me Arsenalin. Atletico Madridi, ekipi që eliminoi Interin, do të përballlet në këtë fazë me Borussia Dortmundin. Një përballje fantastike është ajo mes dy favoritëve kryesorë: Manchester Cityt, ekipi kampion në fuqi, do të përballlet me Real Madridin, pa diskutim përballja më e fortë në këtë fazë. Përballja tjetër në këtë sfidë është PSG - Barcelona. Në Nion, gjatë hedhjes së shortit, është zbardhur edhe rruga drejt finales së madhe, ku edhe në fazën gjysmëfinale pritet përballje fantastike. Fituesi i çiftit, Bayern - Arsenal, do të përballlet me fituesin e çiftit Manchester City - Real Madrid. Fituesi i çiftit Atletico - Dortmund në fazën

### ÇIFTET E ÇEREKFINALES NË LK:

**Arsenal - Bayern Munchen**  
**Ath. Madrid - B. Dortmund**  
**Real Madrid - Manchester City**  
**PSG - Barcelona**

gjysmëfinale do të përballlet me fituesin e çiftit PSG - Barcelona. Ndeshjet e para çerekfinale luhen më 9 dhe 10 prill, kurse ato të kthimit një javë më pas.

### Milani 'peshkon' Romën në Ligën e Evropës

Goglat e shortit u treguan të pamëshirshme për ekipet italiane të cilat do të përplasen ndërmjet tyre në fazën çerekfinale. Shorti prodhoi një derbi italian me Milanin që "peshkoi" Romën në fazë çerekfinale. Nuk ishte me fat as Atalanta e Berat Gjimshiti, me bergamskët që përplasen me ekipin më të fortë të mundshëm, Liverpool. Një nga favoritët e tjerë të këtij turneu, Bayer Leverkusen,

do të përballlet me West Hamin. Çifti tjetër në këtë fazë është Benfica - Marseille. Tetë ekipet pjesëmarrëse në këtë fazë të Ligës së Evropës mësuuan edhe rrugën e tyre drejt finales së madhe. Fituesi i çiftit Milan - Roma do të përballlet me fituesin e çiftit Leverkusen - West Ham. Ndërkohë, fituesi i çiftit Liverpool - Atalanta në fazën gjysmëfinale do të përballlet me fituesin e çiftit Benfica - Olimpik Marsille.

### Short interesant edhe në Ligën e Konferencës

Të premtën është hedhur shorti edhe për çerekfinale të Ligës së Konferencës. Goglat kanë vënë në përballje me njëra-tjetrën disa skuadra interesante.

### PËRBALLJET ÇEREKFINALE:

**Club Brugge - PAOK**  
**Olympiacos-Fenerbahçe**  
**Aston Villa-Lille**  
**Victoria Plzen-Fiorentina.**

## Mançini, gati ta lë Arabinë Saudite për një ekip në Evropë

Roberto Mançini mund të kthehet në një klub, duke u larguar nga Arabia Saudite këtë verë. Nuk dihet nëse ai do të ketë edhe rol të dyfishtë si trajner i

kombëtares. Lajmi i bujshëm vjen nga Anglia, konkretisht nga faqja e specializuar e tregut të transferimeve "Hit.com", e cila

nënvizon se si ish-trajnerit të kampionit të Evropës në fuqi, Italisë, mund t'i ofrohet një punë si trajner i Newcastleit në vend të Edie Hove. Menaxhmenti teknik i

këtij të fundit deri në këtë pikë e ka lënë të pakënaqur fondin PIF që zotëron klubin anglez në fjalë. Vetë fondi arab, ndër më të mëdhenjtë në botë dhe me një pasuri totale

të vlerësuar mbi 776 miliardë dollarë, mund ta shfrytëzojë qartësisht lidhjen e dyfishtë me Arabinë Saudite për t'ia ofruar Mançinit vendin e punës.

### SHKURT

#### Gjimshiti në formacionin e javës në Ligën e Evropës

Mbrojtësi shqiptar i Atalantas, Berat Gjimshiti, ka përfunduar në formacionin më të mirë të ndeshjeve kthyes të fazës së 1/8-tës në Ligën e Evropës. Kapiteni i kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, është në mesin e lojtarëve që është zgjedhur në formacionin e javës nga "SofaScore". Përveç Gjimshitit, në mbrojtje janë edhe Alexander Bah, Jan Paul van Hecke dhe Theo Hernandez, ndërsa në portë Lukas Fabianski. Bobby Clark është mesfushor qendror, ndërsa treshja para tij formohet nga Mohamed Salah, Aleksei Miranchuk, Mohammed Kudus. Në sulm vend kanë zënë Patrik Schick dhe Coady Gakpo.

#### Bostoni dhe Oklahoma komandojnë Konferencat përkatëse

Bostoni vijon të jetë skuadra më e mirë e këtij sezoni në NBA. Ekipi i Celticsit fitoi me rezultat 127-112 ndaj Phoenixit, ku protagonist ishte Browni, autor i 37 pikëve. Ai u mbështet edhe nga Tatum (26 pikë) dhe Hofordi (24 pikë). Fitoi edhe Milwaukee, që mundi me rezultat 114-105 Philadelphian. Maxey realizoi 30 pikë për miqtë, por që mbetën për statistikë. Për Bucksin, Antetokoumpo shënoi 32 pikë e 11 rebounde, duke qenë lider në fushë. Oklahoma rikthehet në krye të renditjes në Perëndim pas fitores me rezultat 126-119 ndaj Dallasit. Të gjithë titullarët e Oklahomas realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Shai me 31 pikë, duke i bërë të pavlefshme 36 pikët e Irvingut. Rezultatet: Boston-Phoenix (127-112), Chicago-Clippers (111-126), Houston-Washington (135-119), Milwaukee-Philadelphia (114-105), Oklahoma-Dallas (126-119), Portland-New York (93-105).

#### 10 klubet më të mira sipas UEFA-së

Rezultatet e raundit të 1/16-të të Ligës së Kampionëve kanë ndryshuar renditjen e klubeve në publikimin e fundit të publikuar nga UEFA. Manchester City mbetet i pari në listë përpara Bayern Munichit dhe Real Madridit, ndërsa ekipi kryesor italian është Interi, i gjashti përpara Romës në vendin e nëntë. Napoli dhe Juventus janë më larg, duke zbritur në vendin e shtatëmbëdhjetë dhe të tetëmbëdhjetë. 10 klubet më të mira sipas UEFA-së: Manchester City (1), Bayern Munchen (2), Real Madrid (3), Paris Saint-Germain (4), Liverpool (5), Inter (6), Leipsig (7), Chelsea (8), Roma (9), Manchester United (10).

#### Griezmann: Dua triumfin në Ligën e Kampionëve

Antoine Griezmann po ëndërron të fitojë Ligën e Kampionëve me Atletico e Madridit 10 vjet pasi iu bashkua klubit nga Real Sociedad. Shorti i hedhur përballi spanjollët me Borussia Dortmundin, një rival që mund të kalohet. "Ëndrra dhe objektivi është të fitojmë La Ligan dhe Ligën e Kampionëve. Nuk e kam fituar kurrë Ligën dhe mund të jem golashënuesi rekord i klubit, por të mos e fitosh është e vështirë. Edhe Liga e Kampionëve do të ishte një ëndërr për të gjithë", ka thënë Griezmanni.

Njoftim për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë “Ariani Arms”, Sh.P.K.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara “Ariani Arms” SH.P.K. me numër

NUI: 812113489, me seli në Vushtrri, lëshon këtë:

**NJOFTIM**

“Ariani Arms” ka vendosur për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë nga: 3.000.000 €, në 3000.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Rexhep Hoti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Lekë Dukagjini” Prizren.

- Laurant Brahimi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “Lekë Dugagjini” Prizren.

- Besijan Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Brigada 125” Medvec.

- Gëzim Halilaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari”.

- Brikena Basha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hysni Zajmi”.

- Dardan Bajrami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Valmir Rragamaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12. të sh.m. teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Alban Selimi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjin Gazulli” Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

